Nr. Rendor	Zona kadastrale dhe indeksi I hartes	Nr. I pasurise	Lloji i prones	Emri i Prones Adresa	Sip. totale e prones (m2)	Nga Sip.totale sa ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
859	8531	6/293	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	320.37		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
860	8531	6/531	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	379.64		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
861	8531	6/323	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	498.35		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
862	8531	6/331	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	161.22		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
863	8531	6/312	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	675.39		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia: FIER
Zona Kadastrale 8531

Identifikoi: Erdiola Dhanili (Specialist)
Hyrisha Taco (Specialist)
Pranvera Toska (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Erald Filipi (Drejtor)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Armando SUBASHI (Kryetar I Bashkise)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

MIRATOHET
Kryetar i Keshillit Bashkiak
Vangjel NDREKA

Fusha e perdorimit te prones:
Troje te lira dhe hapesira publike te pazena ndermjet ndertesave ose objekteve te cdo lloji

	A			B			C			
Nr. Rendor	Zona kadastrale dhe indeksi I hartes	Nr. I pasurise	Lloji i prones	Emri i Prones Adresa	Sip. totale e prones (m2)	Nga Sip.totale sa ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
864	8531	6/304	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	370.5		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
865	8531	6/365	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	856.38		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
866	8531	6/10	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	1139.87		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
867	8531	6/360	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	325.45		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
868	8531	6/359	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	19.78		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia: FIER
Zona Kadastrale 8531

Identifikoi: Erdiola Dhanili (Specialist)
Hyrisha Taco (Specialist)
Pranvera Toska (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Erald Filipi (Drejtor)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Armando SUBASHI (Kryetar I Bashkise)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

MIRATOHET
Kryetar i Keshillit Bashkiak
Vangjel NDREKA

Fusha e perdorimit te prones:
Troje te lira dhe hapesira publike te pazena ndermjet ndertesave ose objekteve te cdo lloji

	A			B			C			
Nr. Rendor	Zona kadastrale dhe indeksi I hartes	Nr. I pasurise	Lloji i prones	Emri i Prones Adresa	Sip. totale e prones (m2)	Nga Sip.totale sa ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
869	8531	6/357	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	192.03		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
870	8531	6/358	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	832.13		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
871	8531	6/298	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	37.56		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
872	8531	6/372	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	51.07		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
873	8531	6/371	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	201.49		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia: FIER
Zona Kadastrale 8531

Identifikoi: Erdiola Dhanili (Specialist)
Hyrisha Taco (Specialist)
Pranvera Toska (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Erald Filipi (Drejtor)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Armando SUBASHI (Kryetar I Bashkise)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

MIRATOHET
Kryetar i Keshillit Bashkiak
Vangjel NDREKA

Fusha e perdorimit te prones:
Troje te lira dhe hapesira publike te pazena ndermjet ndertesave ose objekteve te cdo lloji

	A			B			C			
Nr. Rendor	Zona kadastrale dhe indeksi I hartes	Nr. I pasurise	Lloji i prones	Emri i Prones Adresa	Sip. totale e prones (m2)	Nga Sip.totale sa ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
874	8531	6/314	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	1361.31		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
875	8531	6/205	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	703.62		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
876	8531	6/534	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	36.4		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
877	8531	6/356	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	843.68		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	
878	8531	6/494	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	117.93		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia: FIER
Zona Kadastrale 8531

Identifikoi: Erdiola Dhanili (Specialist)
Hyrisha Taco (Specialist)
Pranvera Toska (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Erald Filipi (Drejtor)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Armando SUBASHI (Kryetar I Bashkise)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula

MIRATOHET
Kryetar i Keshillit Bashkiak
Vangjel NDREKA

Fusha e perdorimit te prones:
Troje te lira dhe hapesira publike te pazena ndermjet ndertesave ose objekteve te cdo lloji

	A			B			C			
Nr. Rendor	Zona kadastrale dhe indeksi I hartes	Nr. I pasurise	Lloji i prones	Emri i Prones Adresa	Sip. totale e prones (m2)	Nga Sip.totale sa ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
879	8531	6/330	Truall	Truall Lagja "11 Janari" Perbri Prefektures, Perball Bashkise Fier	76.88		Truall	Bashkia Fier	Bashkia Fier	

HARTE KADASTRALE
(Fragment)

AGJENCIA SHTETËRORE
E KADASTRËS

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARTAN LAME

Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë
Drejtor Andi PROKO

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË
ZONA KADASTRALE: 8531 NR.I.PASURISË: ___ Vol ___ Fq ___
INDEKSI I HARTËS: FR-L-5, 6 DHE FR-M-5, 6 SHKALLA: 1:1000
ADRESA E PASURISË: FIER Q/F FIER
Rr. _____ P/G SH K AP
B. KUFIZIMET C. PRONARI
VERI: ___
JUG: ___
LINDJE: ___
PERENDIM: ___ SHTET
Data: 14.01.2020 Ora:

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



VENDIM
Nr. 300, datë 15.4.2020

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË SHKËMBIMIT TË BANESËS ME KOSTO TË ULËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 48, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Familjet që kanë siguruar banesa sociale me kosto të ulët, të cilat më vonë rezultojnë nën normat e strehimit për shkak të ndryshimit të përbërjes familjare dhe aplikojnë në njësinë e vetëqeverisjes vendore për zgjerim nëpërmjet programit të banesave me kosto të ulët, dorëzojnë banesën që kanë përfituar më parë, në shkëmbim të një banese sipas normave të strehimit që i përshtaten familjes.

2. Vlerësimi i banesave që shkëmbehen, kur njësia e vetëqeverisjes vendore ka siguruar banesën me kosto të ulët përmes ndërtimeve të reja, kryhet, si më poshtë vijon:

a) Vlera e banesës që dorëzohet nga individi/familja vlerësohet nga subjekti që zbaton programin me koston e ndërtimit, duke zbritur vlerën e amortizimit;

b) Vlera e banesës që shkëmbehet me banesën e dorëzuar nga familja përfshin të gjitha kostot që janë investuar për sigurimin e banesës, ku përfshihen:

i. kostot e ndërtimit, si:

i/1. kostot e projektit;

i/2. kostot e ndërtimit të objektit, të mbikëqyrjes, të kolaudimit;

i/3. kostot për lidhjen e objektit me energji, ujë, kanalizime e telefoni;

i/4. kostot për regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

ii. kostot operacionale, ku përfshihen kostot për punën e stafit të angazhuar, materiale, energji etj., të cilat miratohen me vendim të organit drejtues të institucionit që zbaton programin, të shprehur në përqindje ndaj kostos së ndërtimit sipas nënndarjes "i", të shkronjës "b", të kësaj pike, por jo më shumë se 1% kur projekti është realizuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

iii. shpenzime për marrjen e lejeve, regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, taksa e detyrime të tjera që nuk janë përfshirë në nënndarjet "i" dhe "ii", të kësaj pike;

iv. vlera e truallit, e cila përcaktohet sipas vlerave të tregut të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për qëllim kompensimi.

3. Në rastet kur banesa me kosto të ulët është siguruar nëpërmjet blerjes në tregun e lirë, vlerësimi i banesave që shkëmbehen bëhet, si më poshtë vijon:

a) Vlera e banesës që dorëzohet nga qytetari vlerësohet nga vlerësues të licencuar;

b) Vlera e banesës në pronësi të subjektit që zbaton programin, e cila do të shkëmbehet, përfshin, sa më poshtë:

i. Vlerën me të cilën është blerë banesa në treg;

ii. Kostot për regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për lidhjen e kontratës dhe çdo shpenzim tjetër të faturuar;

iii. Shpenzimet operacionale, të cilat, kur programi zbatohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nuk mund të jenë më shumë se 0,5% e çmimit të blerjes, sipas nënndarjes "i", të shkronjës "b", të kësaj pike.

4. Diferenca që rezulton midis vlerës së banesës me kosto të ulët që merr përfituesi dhe vlerës së banesës ekzistuese shlyhet në mënyrë të menjëhershme ose me këste. Afati i shlyerjes dhe interesi vjetor përcaktohen nga subjekti që zbaton programin dhe miratohen me vendim të organit drejtues.

5. Procedura e shkëmbimit të banesave sociale për individët/familjet e interesuar/a, që janë në kushtet e pikës 1, të këtij vendimi, fillon kur subjekti që zbaton programin ka siguruar banesa me kosto të ulët nëpërmjet ndërtimit ose blerjes nga tregu i lirë për t'ua shitur individëve/familjeve që kanë aplikuar për këtë program, sipas vendimit nr.384, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore".

6. Struktura e strehimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore verifikon gjendjen e familjes, të sipërfaqes së banimit në banesën ekzistuese të përfituar nga privatizimet ose nga

blerja në treg, si dhe të mundësive për ofrimin e një banese me kosto të ulët, në përputhje me normat e strehimit të zbatueshme për gjendjen dhe nevojat e familjes përfituese.

7. Vendimi për pranimin ose jo të kërkesës merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë gjykatës administrative.

8. Kontrata e shkëmbimit të të dyja banesave bëhet në përputhje me parashikimet e Kodit Civil për këtë kontratë. Kontrata e shkëmbimit, e lidhur ndërmjet familjes që përfiton nga shkëmbimi me njësinë e vetëqeverisjes vendore, bëhet me akt noterial.

9. Kontrata e shkëmbimit ka si objekt:

a) kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të familjes përfituese për banesën e re që përfitohet nga shkëmbimi me sipërfaqen e banimit, brenda normave të nevojshme;

b) kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të njësisë së vetëqeverisjes vendore mbi banesën sociale ekzistuese që është nën normën e strehimit dhe kalimin e saj si pjesë e fondit publik të banesave dhe/ose vënien e saj në dispozicion të programit të banesave me kosto të ulët;

c) vlerësimin e banesave që do të shkëmbehen, sipas pikave 2 ose 3, të këtij vendimi, në varësi të formës së sigurimit të banesave që shkëmbehen.

ç) përcaktimin e mënyrës së shlyerjes së diferencës sipas pikës 4, të këtij vendimi, me këste ose në mënyrë të menjëhershme;

d) përcaktimin e rezervës së pronësisë në favor të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rastin kur shlyerja bëhet me këste, deri në shlyerjen e plotë të diferencës së vlerës së banesës që përfitohet nga shkëmbimi;

dh) përcaktimin se me shlyerjen e plotë të vlerës së banesës së re të përfituar nga shkëmbimi, pronësia i kalon familjes përfituese.

10. Njësia e vetëqeverisjes vendore merr masa për depozitimin e kontratës pranë zyrës vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe ndjek procedurat e kalimit të pronësisë sipas kontratës së shkëmbimit. Shpenzimet për regjistrimin e këtyre kontratave mbulohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

11. Njësia e vetëqeverisjes vendore pajis familjen me një kopje të vërtetimit të regjistrimit të tagrit të pronësisë së banesës së re.

12. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 301, datë 15.4.2020

PËR NORMAT E STREHIMIT, SI DHE KUSHTET E STANDARDET PËR BANESAT SOCIALE ME QIRA QË BLIHEN NË TREG DHE BANESAT ME KOSTO TË ULËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 13, të pikës 3, të nenit 21, të pikës 3, të nenit 45, dhe të pikës 3, të nenit 48, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë:

a) normën e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit,

b) kushtet dhe standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg;

c) standardet e banesave me kosto të ulët.

2. Çdo kusht apo standard ndërtimi për banesat sociale sipas programeve të parashikuara në ligjin nr.22/2018, "Për strehimin social", që nuk është parashikuar në këtë vendim, zbatohet në përputhje me kushtet dhe standardet e ndërtimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Norma e strehimit për programet e strehimit social, në përputhje me parimet e politikave të strehimit, bazuar në nenet 3 deri 10, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", është 30 m^2 sipërfaqe neto për personin e parë. Për çdo person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10m^2 dhe llogaritet sipas formulës më poshtë:

Sipërfaqja Neto e Banesës = 20m^2 + N x 10 m^2

Ku:

Sipërfaqja neto e banesës: është sipërfaqja e shfrytëzimit pa muret e brendshme dhe

perimetralë, e quajtur ndryshe si sipërfaqja e përdorshme ose e shkeljes.

N është numri i banorëve mbi moshën 5 (pesë) vjeç.

4. Kur në përbërje të familjes ka një a më shumë persona me aftësi të kufizuara, norma e strehimit për personin e parë është $40m^2$. Për çdo person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me $10m^2$ dhe llogaritet sipas formulës:

Sipërfaqja Neto e Banesës = $30m^2$ + N x $10m^2$

Ku:

'Sipërfaqja neto e banesës' dhe 'N' kanë kuptimin si në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Banesë e mbipopulluar quhet ajo banesë që plotëson njërin ose disa prej kushteve të mëposhtme:

a) Kur ka sipërfaqe banimi neto më të vogël se norma e strehimit;

b) Kur më shumë se dy persona që shfrytëzojnë një dhomë gjumi;

c) Kur dy persona me seks të ndryshëm mbi moshën 10 vjeç dhe që nuk janë në lidhje martesore ose bashkëjetese shfrytëzojnë një dhomë gjumi.

6. Një dhomë gjumi në një njësi banimi mund të shfrytëzohet nga:

- një çift;
- dy individë të të njëjtit seks;
- 2 individë me seks të ndryshëm nën moshën 10 vjeç;
- një individ.

7. Norma e shfrytëzimit të hapësirave të banimit pasqyrohet në tabelën nr.1 në vijim.

Tabela 1: Shfrytëzimi i mundshëm i njësive të banimit

Tipi i njësisë së banimit	Numri i dhomave të gjumit	N – Numri i banorëve	Dhoma 1	Dhoma 2	Dhoma 3
Studio	-	1-2	1P / çift	-	-
1+1	1	2	çift	-	-
2+1	2	3-4	1P / çift	1P / MM / FF	-
3+1	3	4-6	1P / çift	1P / MM / FF	1P / MM / FF

8. Kushtet dhe standardet e parashikuara në këtë vendim zbatohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave, si dhe çdo institucion tjetër publik ose privat, për programet e mëposhtme të strehimit social:

a) Programi i banesave sociale me qira (BSQ);

b) Programi i banesave me kosto të ulët (BKU).

9. Banesat sociale ndërtohen, blihen nga tregu apo përshtaten në zona të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Janë të pastra nga ndotja e ajrit, ndotja e tokës apo forma të tjera që përbëjnë rreziqe shëndetësore, kërcënime dhe rreziqe natyrore ose njerëzore, sipas legjislacionit në fuqi mbi mbrojtjen civile, mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ajrit në mjedis;

b) Janë të ekspozuara mirë ndaj rrezatimit diellor;

c) Respektojnë legjislacionin në fuqi lidhur me ekspozimin ndaj nivelit të zhurmave;

ç) Ofrojnë akses të automjeteve, furnizim me ujë dhe energji elektrike;

d) Mundësojnë akses në shërbimet publike bazë në distancë të përshkueshme në këmbë ose përmes transportit të rregullt publik.

10. Banesat sociale, që ndërtohen, blihen nga tregu ose përshtaten, përmbushin të gjitha rregullat në fuqi në respektim të mjedisit, si dhe kushtet e mëposhtme:

a) Konsumi i energjisë të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për performancën energjetike të ndërtesave;

b) Përqendrimi i nivelit të radonit në mjediset e brendshme të jetë sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.

11. Banesat sociale, që ndërtohen, blihen nga tregu apo përshtaten, duhet të plotësojnë këto kushte:

a) Lartësia minimale dysheme-tavan për hapësirat e banimit në njësitë e banimit nuk duhet të jetë më e vogël se 265 cm;

b) Lartësia minimale dysheme-tavan për hapësirat e shërbimit dhe në bodrume nuk duhet të jetë më e vogël se 240 cm;

c) Të sigurojnë parkim për biçikleta;

ç) Të sigurojnë të paktën 1 hapësirë parkimi për çdo 5 njësi banimi, e cila, sipas rastit, mund të jetë brenda ose jashtë ndërtesës;

d) Mbështjellësja e ndërtesës të projektohet për të mundësuar që rrjedhja e ajrit të jetë minimale, rezistenca termike të jetë e lartë dhe të eliminohen urat termike, të maksimizohet përfitimi diellor gjatë dimrit dhe të minimizohet gjatë verës;

dh) Orientimi i objekteve të maksimizojë ekspozimin nga jugu dhe sigurimin e ajrosjes tërthore;

e) Fasadat me orientim nga jugu dhe perëndimi, veçanërisht në zonat me verë të nxehtë, të jenë të pajisura me hijezues;

ë) Kur është e mundur, të sigurojnë instalimin e paneleve diellore për ngrohjen e ujit dhe paneleve fotovoltaike;

f) Në sistemimet e jashtme të ndërtesave të përdoren materiale të përshkueshme, ku të paktën 20% e sipërfaqes të jetë e përshkueshme;

g) Sistemimet e mjediseve të jashtme të maksimizojnë sipërfaqet e gjelbra dhe natyrore dhe të minimizojnë përdorimin e materialeve ndërtimore;

gj) Të jenë të pajisura me ashensorë të përshtatshëm për akses nga persona me aftësi të kufizuara, në masën një ashensor për jo më shumë se 75 njësi banimi;

h) Kur është e mundur, të sigurojnë projektimin e tarracave të gjelbra ose mbulesave të shfrytëzueshme si hapësirë sociale për banorët.

12. Në ndërtimin e banesave sociale, njësitë e vetëqeverisjes vendore nxisin dhe përhapin shembujt më të mirë në përdorimin e materialeve të ndërtimit miqësore për mjedisin, si materiale të ricikluara, materiale lehtësisht të ricikluesshme, materiale për prodhimin e të cilave shkaktohet impakt mjedisor minimal, materiale që mundësojnë kursim të lartë të energjisë etj.

13. Njësia e banimit në një banesë sociale, që ndërtohet, blihet ose përshtatet, përfshin të paktën një dhomë ndenjieje, një hapësirë ngrënieje, një kuzhinë, një dhomë gjumi për dy veta, një ballkon dhe një banjë. Njësia e banimit mund të jetë edhe një banesë studio apo banesë me një dhomë të vetme (garsonierë), ku të gjitha mjediset e përmendura në këtë pikë të këtij vendimi kombinohen në një hapësirë të vetme, përveç ballkonit dhe banjës, të cilat janë të ndara.

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurohen që ndërtimet, për të cilat kërkohet leje zhvillimore dhe do të përdoren për strehim social, të jenë të orientuara në mënyrë të tillë që të përfitojnë nga ajrimi natyror dhe rrezatimi diellor, aty ku është e mundur të jenë të orientuara në dy drejtime të horizontit, dhe, të paktën një nga dhomat e banesës të ekspozohet ndaj rrezatimit diellor për të paktën dy orë në ditë, e matur në solsticin dimëror (20-23 dhjetor).

15. Hapësirat minimale të shfrytëzueshme në një banesë sociale që ndërtohet, blihet ose përshtatet si dhe sipërfaqja neto maksimale e lejuar për llojet më të zakonshme të njësive të banimit janë sipas tabelës nr.2:

Tabela nr. 2: Sipërfaqja neto minimale dhe maksimale për llojet më të zakonshme të njësive të banimit.

Sipërfaqet për çdo lloj banese		
Tipi i njësisë së banimit	Sipërfaqja Neto (m2)	
	Minimale	Maksimale
Studio	30	45
1+1	40	55
2+1	50	81
3+1	60	100

16. Në njësitë e banimit në banesat sociale që ndërtohen, blihen ose përshtaten, plotësohen këto kushte e standarde:

a) Kuzhina duhet të jetë e pajisur me lavapjatë dhe sistem mekanik për nxjerrjen e avujve që vendoset mbi sipërfaqen e gatimit. Në lavapjatë duhet të ketë ujë të nxehtë. Muri pranë lavapjatës dhe rreth sobës së gatimit duhet të vishet me materiale të cilat janë të lehta për t'u pastruar dhe rezistente ndaj temperaturave të larta dhe lagështisë;

b) Banja duhet të jetë e pajisur me WC, lavaman dhe dush. Instalimi i vaskave ose i bideve është në varësi të hapësirës, buxhetit dhe kërkesave specifike. Banja duhet të furnizohet me ujë të nxehtë. Sipërfaqet e mureve të banjës duhet të jenë të trajtuara deri në lartësinë 2m me materiale të cilat pastrohen me lehtësi dhe që janë rezistente ndaj lagështisë. Dyshemeja duhet të jetë e padepërtueshme nga uji dhe rezistente ndaj rrëshqitjes. Në ndërtimet e reja dhe objektet që përshtaten, duhet të sigurohet ajrim mekanik në nivelin 15 (pesëmbëdhjetë) ndërrime të ajrit në orë;

c) Ballkoni, lozha, veranda, tarraca ofrojnë hapësirë për zgjerimin e ambientit të ndenjies në mjedisin e jashtëm. Kur është e mundur, në klima të ftohta, me qëllim përthithjen e energjisë diellore dhe ruajtjen e nxehtësisë në dimër, duhet të sigurohet mbyllja me xham e ballkoneve. Në ndërtimet e reja, rekomandohet që zona e ballkonit të rritet proporcionalisht me numrin e banorëve, duke siguruar së paku 0.6 m²/banor;

ç) Dhoma e gjumit duhet të sigurojë hapësirë për shtretër dhe hapësira private për një ose dy banorë. Të gjitha dhomat e gjumit duhet të aksesohen të pavarura, në mënyrë që të mos kalohet përmes asnjërës prej tyre për të hyrë në një dhomë tjetër gjumi.

17. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, Enti Kombëtar i Banesave si dhe çdo institucion tjetër publik ose privat, që zbaton programe sociale strehimi nëpërmjet blerjes së banesave nga tregu, kur është e mundur, duhet të sigurojnë në maksimum zbatimin e kushteve dhe standardeve të përcaktuara në këtë vendim.

18. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurohen që ndërtimet, për të cilat kërkohet leje zhvillimore dhe që do të përdoren për strehim social, të plotësojnë kushtet dhe standardet e parashikuara në këtë vendim.

19. Kur është e mundur teknikisht dhe kostot e investimeve janë të arsyeshme, me qëllim përmirësimin e kushteve të banesave sociale të blera në treg apo atyre ekzistuese, mund të bëhen ndërhyrje, veçanërisht për përmirësimin e performancës energjetike të banesës, pastrimin e ajrit ose tokës së ndotur, eliminimin ose reduktimin e zhurmave, eliminimin e lagështirës etj.

20. Ngarkohen Enti Kombëtar i Banesave, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo institucion tjetër publik a privat që zbaton programe sociale strehimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 304, datë 15.4.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, FAZA E PESTË, NJËSIA ADMINISTRATIVE PORTËZ, FSHATI MBYET", FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike, faza e pestë, njësia administrative Portëz, fshati Mbyet", Fier.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "tokë bujqësore", me një vlerë të përgjithshme prej 1 863 363 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 863 363 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Fier.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, Bashkia Fier.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Fier, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Bashkia Fier, për pasurinë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Fier dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit: "Zgjerimi i Varrezave Publike, faza e pestë, Njësia Administrative Portëz, fshati Mbyet" Fier
Vlerësimi për pasurinë tokë arë, është bërë sipas vendimit nr.89, datë 3.2.2016

Nr.	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr/pasuri së	Sipërfa. e përgjithshme, tokë buqësore / m²	Sipëfaq. Që preket. Tokë buqësore / m²	Çmimi Tokë buqësore / m²	Vlera e Tokës buqësore / lekë	Vlera totale / Lekë	Konfirmuar nga ASHK
1	Elca Myzafer Hoxhaj	2637	288/126	1500	1500	269	403,500	403,500	Certifikatë pronësie
2	Selvi Xhafa (Hoxhaj), Hasmen Hoxhaj, Lavdie Llanaj, Behije Qose, Xhevaire Shehaj, Sare Meta, Ramazan Hoxhaj, Merita Sadushi, Kozeta Kalemi	2637	288/89	5427	5427	269	1,459,863	1,459,863	Certifikatë pronësie
Vlera totale e shpronësimit				**6927**	**6927**			**1,863,363**	

VENDIM
Nr. 306, datë 15.4.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020,PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pikat 1 dhe 2, të vendimit nr.202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 7 280 349 288 (shtatë miliardë e dyqind e tetëdhjetë milionë e treqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, sipas projekteve model të miratuara.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t'u kalojë njësive zbatuese, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", në masën prej 5 440 470 210 (pesë miliardë e katërqind e dyzet milionë e katërqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind e dhjetë) lekësh pa TVSH.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 1 839 879 078 (një miliardë e tetëqind e tridhjetë e nëntë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 312, datë 18.4.2020

PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.243, DATË 24.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të neneve 100 dhe 174, pika 2, të Kushtetutës, dhe të shkronjës "d", të nenit 18, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur me vendimin nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", deri në datën 23.6.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 313, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 8, ME OBJEKT "BLERJA BARNA OMEPRAZOL 40 MG/VIAL FLAKON"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 8, me objekt "Blerja barna Omeprazol 40 mg/vial flakon", me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "MEGAPHARMA", sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt "Blerje barna kundër Coronavirus COVID–19, ndarë në 10 lote (një bar një lot)", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 314, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 5, ME OBJEKT "BLERJE BARNA OSELTAMIVIR (TAMIFLU) 75 MG/TABLETË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 5, me objekt "Blerje barna Oseltamivir (Tamiflu) 75 mg/tabletë", me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "REJSI FARMA", sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt "Blerje barna kundër Coronavirus COVID–19, ndarë në dhjetë lote (një bar një lot)", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 315, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 10, ME OBJEKT "BLERJE BARNA BECLOMETHASONE + SALBUTAMOL 80 MCG+1600 MCG FLAKON"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 10, me objekt "Blerje barna Beclomethasone + Salbutamol 80 mcg+1600 mcg flakon", me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "MEDICAMENTA", sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt "Blerje barna kundër Coronavirus COVID–19,

ndarë në 10 lote (një bar një lot)", që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 316, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 2, ME OBJEKT "BLERJE KITE DHE MATERIALE KONSUMI PËR BIOLOGJINË MOLEKULARE PËR ISHP"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 2, me objekt "Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP", të procedurës "Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP", ndarë në lote, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "Biometric Albania", sh.p.k., që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 317, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 3, ME OBJEKT "BLERJE MATERIALE KONSUMI LABORATORIKE PËR ISHP"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 3, me objekt "Blerje materiale konsumi laboratorike për ISHP", të procedurës "Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP", ndarë në lote, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "Krijon", sh.p.k., sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 318, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 3, ME OBJEKT "BLERJE BARNA RIBAVIRIN 200 M TABLETË/KAPSULË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë

26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 3, me objekt "Blerje barna Ribavirin 200 mg tabletë/kapsulë", me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "REJSI FARMA", sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt "Blerje barna kundër Coronavirus COVID–19, ndarë në 10 (dhjetë) lote (një bar një lot)", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 319, datë 18.4.2020

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ORGANIKË DHE TË FONDEVE BUXHETORE NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 17, të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të grupit 87 "Institucioneve të tjera qeveritare", për vitin 2020, shtohet me 7 (shtatë) punonjës për Njësinë Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij grupi në 1 204 (një mijë e dyqind e katër) punonjës.

2. Numri i punonjësve të Kryeministrisë, për vitin 2020, reduktohet me 7 (shtatë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) punonjës.

3. Në programin "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi", të miratuar për vitin 2020 për Kryeministrinë, reduktohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh, në zërin "shpenzime korrente".

4. Në programin "Shërbime të tjera", të miratuar për vitin 2020, për grupin 87 "Institucioneve të tjera qeveritare", shtohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh, në zërin "shpenzime korrente".

5. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Njësia Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 320, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS ME OBJEKT "BLERJE BARNA PROPOFOL 10 MG/ML – 50 ML FLAKON" PËR LOTIN 9, TË PROCEDURËS ME OBJEKT "BLERJE BARNA KUNDËR CORONAVIRUS COVID – 19, NDARË NË 10 LOTE (NJË BAR NJË LOT)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës me objekt "Blerje barna Propofol 10 mg/ml – 50 ml Flakon", ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorit ekonomik "REJSI FARMA", sh.p.k., për lotin 9, të procedurës me objekt "Blerje

barna kundër Coronavirus COVID–19, ndarë në 10 lote (një bar një lot)", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 321, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 1, ME OBJEKT "FURNIZIM ME PRODUKTE LETRE NJËPËRDORIMSHE TË TIPIT LETËR RULO TAVOLINE DHE LETËR HIGJIENIKE, PËR PACIENTËT ME COVID-19 DHE PERSONELIN MJEKËSOR", NË QSUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 1, me objekt "Furnizim me produkte letre njëpërdorimshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjienike, për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor" në QSUT, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "EUROMEGA 2010", sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt "Produkte letre si dhe spostimin e sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve të QSUT-së te godina e spitalit infektiv në QSUT (Shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19)", ndarë në dy lote, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 322, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 1, ME OBJEKT "BLERJE KITE PËR LABORATORIN MIKROBIOLOGJIK PËR DIAGNOZËN SEROLOGJIKE, TË PËRSHTATSHME PËR PAJISJEN MAGLUM 800 TË SNIBE CO.LTD OSE EKUIVALENT", NË QSUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 1, me objekt "Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen Maglum 800 të Snibe Co.ltd ose Ekuivalent", në QSUT, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "GENIUS", sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt "Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen Maglum 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP", ndarë në katër lote, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 323, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 2 ME OBJEKT "SPOSTIMI I SISTEMIT TË DIALIZËS NGA PEDIATRIA E SPECIALITETEVE TEK GODINA E SPITALIT INFEKTIV (SHËRBIMI I ALERGOLOGJISË, PËR PACIENTËT DIALIZANTË TË PREKUR ME COVID-19)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 2, me objekt "Spostimi i sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve tek godina e spitalit infektiv (Shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19)", me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik "TEOREN", sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt "Produkte letre si dhe spostimin e sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve të QSUT-së tek godina e spitalit infektiv në QSUT (Shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19)", ndarë në dy lote, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë